



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3336/7 prot.

Datë 16.12.2024

V E N D I M
Nr. 1771/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur-Punë”, me Nr. REF-22803-10-04-2024, me objekt “Rikonstruksion Objekti, Heqje dhe Furnizim-Vendosje Dyer dhe Dritare për FSHMT, Tiranë”, me fond limit 36,912,500 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind), zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK, me NUIS K71401004Ë, me adresë: Tiranë,

Rruga “Adem Jashari”, Ndërtesa 4, Hyrja 10, Njësia Bashkiake Nr.5.

BOE “DRINI-1” SHPK & “NDËRTIMI” SHPK me NUIS J78716317H dhe K11325002C, me adresë: Lagjia Lajthiza, Ish zona industriale, pasuria nr. 1567, Zona Kadastrale nr. 3069, qyteti Pukë. & “NDËRTIMI” shpk.

Autoriteti Kontraktor:

Universiteti Mjekësisë, Tiranë, me adresë: “Rruga e Dibrës”, Nr. 371, 1005, Tiranë.

Subjekte të interesuara:

Operatori ekonomik “INA” SHPK, me NUIS J61814009Ë, me adresë: Tiranë, Rruga “Besim Imami”, Myslym Shyri, (mbrapa karburantit).

Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK, me NUIS K71401004Ë, me adresë: Tiranë, Rruga “Adem Jashari”, Ndërtesa 4, Hyrja 10, Njësia Bashkiake Nr.5.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.5. Operatori ekonomik ankimues, “Kevin Konstruksion” SHPK, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Operatori ekonomik ankimues, BOE “Drini-1” & “Ndërtimi” SHPK, nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur-Punë*”, me Nr. REF-22803-10-04-2024, me objekt “*Rikonstruksion Objekti, Heqje dhe Furnizim-Vendosje Dyer dhe Dritare për FSHMT, Tiranë*”, me fond limit 36,912,500 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind), zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

II.2. Në datën 22.10.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 30.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

INA SHPK

30,234,001.56

Kualifikuar

Kevin Konstruktion SHPK	30,450,030.64	Kualifikuar
BOE “Drini -1+ Ndërtimi” SHPK	34,839,270.00	Kualifikuar
“Ndregjoni” SHPK	36,251,969	Kualifikuar

II.4. Në datën 06.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur OE “INA”shpk.

II.5. Në datën 12.11.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3336/2024 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4779 e operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

II.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3336/2 prot., datë 14.11.2024, lidhur me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.2. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor me shkresën nr.2372/29 prot., datë 21.11.2024, protokolluar me tonën me nr.3336/3prot., datë 21.11.2024, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK duke argumentuar si më poshtë vijon: [...] *II.Përsa i përket argumentimit të OE ankues lidhur me përmbushjen e plotësimit të rubrikave në Shtojcën 8 (Shtojce për t'u paraqitur nga operatori ekonomik) FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT, A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT; Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontratë koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme” KSHA konstaton se tek kjo rubrikë OE ka vendosur shënimin “Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme”. Kjo deklaratë nuk mbështetet nga asnjë Vetdeklaratë e paraqitur më vete në dokumentat e paraqitura në SPE.* Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". i ndryshuar, **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron**

IV. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me Formulari i vetëdeklarimit ka ndryshime si ne forme, por dhe ne përmbajtje Operatori ka fshirë pjesën e formularit që ka të bëjë me: "Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

-Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/i pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

-Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetëdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike."

Gjykojmë se, operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP do oferte e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. KSHA konstaton se kjo pjesë e Formularit të Vetëdeklarimit mungon dhe është hequr nga formulari.

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshu **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron.**

VI. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 8, që ka të bëjë me 16 punonjes specialiste duro-alumini/plastik PVC, pasi diplomat/dëshmitë që vërtetojnë kualifikimin profesional nuk janë të lëshuara nga institucion i akredituar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore në Shqipëri, KSHA konstaton se OE "INA" shpik i ka paraqitur në Formularin e Vetëdeklarimit këto certifikata të lëshuara nga QTA. Ky institucion në programin e vet nuk kurse për specialiste duro-alumini/plastik PVC. Gjithashtu në Formularin e Vetëdeklarimit nuk janë plotësuar të dhënat që kërkon Autoriteti Kontraktor sipas kriterit: Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emër/mbiemër, profili i punës (titulli diplomës/certifikatës së lëshuar kualifikimin përkatës kualifikimit), numri amzës, institucionin që ka lëshuar kualifikimin përkatës. Bashkëlidhur dokumenti i paraqitur në SPE dhe informacioni në lidhje me QTA.

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron.**

VIII. Përsa i përket argumentit të OE ankues lidhur me pretendimin se OE nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 12. Pika 1, shkronja b), pasi për Kanionin me vinte të marrë me qira, së pari nuk ka paraqitur certifikatë për transport mallrash brenda vendit (për të tretët) si dhe së dyti, kontrata nuk është për objektin e procedurës objekt ankese, KSHA

konstaton se në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk janë deklaruar të dhënat dhe nuk ka paraqitur certifikatë për transport mallrash brenda vendit sipas kriterit 12 në DST, konkretisht:

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarku paraqitet a dokumenti vërteton vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron.**

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 e Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, sipas të cilës "Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës. 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës", Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, **VENDOSI:**

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të OE "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k., për procedurën "Rikonstruksion Objekti, Heqje dhe Furnizim-Vendosje Dyer dhe Dritare për FSHMT, Tiranë", me nr. REF-22803-10-04-2024.

2. Dërgimin e vendimit të arsyetuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatorit Ekonomik "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k. dhe operatorët ekonomikë të interesuar.

II.5.3. Vendimin e KSHA nr. 2372/29 prot., datë 21.11.2024, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Kevin Konstruksion" SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr 2372/31 prot, datë 25.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3336/4 prot., datë 26.11.2024.

II.5.4. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

II.6. Në datën 13.11.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4787 dhe me nr. 3347/1/2024 protokoli, datë 13.11.2024, e BOE "Drini-1" shpk & "Ndërtimi" SHPK, lidhur me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Ina" SHPK dhe "Kevin Konstruksion" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3347/3 prot, datë 14.11.2024, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ina” SHPK dhe “Kevin Konstruktion” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6.3.Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, në datën 16.11.2024, operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, në cilësinë e subjektit të interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, argumenta të cilat janë protokolluar me shkresën nr.3347/4 prot, datë 18.11.2024.

II.6.4. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor me shkresën nr.2372/30 prot., datë 21.11.2024, protokolluar me tonën me nr.3347/5prot., datë 21.11.2024, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK.

II.6.5.Vendimin e KSHA nr.2372/30 prot.,datë 21.11.2024, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr 2372/31prot, datë 25.11.2024, protokolluar me tonën me nr.3347/6prot., datë 26.11.2024.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Ina” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor me shkresën nr.2372/29 prot., datë 21.11.2024, protokolluar me tonën me nr.3336/3 prot., datë 21.11.2024, ka përcjellë

vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK.

III.1.2.Referuar vendimit të KSHA, nr.2372/29 prot., datë 21.11.2024 rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK duke argumentuar si më poshtë vijon: [...] II. Përsa i përket argumentimit të OE ankues lidhur me përmbushjen e plotësimit të rubrikave në Shtojcën 8 (Shtojce per t'u paraqitur nga operatori ekonomik) FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT, A: DEKLARATA PER PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT; Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontratë koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme” KSHA konstaton se tek kjo rubrikë OE ka vendosur shënimin “Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme”. Kjo deklaratë nuk mbështetet nga asnjë Vetëdeklaratë e paraqitur më vete në dokumentet e paraqitura në SPE.

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". i ndryshuar, **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron**

IV. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me Formulari i vetëdeklarimit ka ndryshime si ne forme por dhe ne përmbajtje Operatori ka fshirë pjesën e formularit qe ka te bëjë me: "Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/i pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetëdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike."

Gjykojmë se, operatoret ekonomike janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim te LPP do oferte e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. KSHA konstaton se kjo pjesë e Formularit të Vetëdeklarimit mungon dhe është hequr nga formulari.

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshu **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron.**

VI. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me Nuk përmbush kriterin e veçante të kualifikimit, pika 8, që ka të bëjë me 16 punonjës specialiste duro-alumini/plastik PVC, pasi diplomat/dëshmitë që vërtetojnë kualifikimin profesional nuk janë të lëshuara nga institucion i akredituar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore në Shqipëri, KSHA konstaton se OE "INA" shpik i ka paraqitur në Formularin e Vetëdeklarimit këto certifikata të lëshuara nga QTA. Ky institucion në programin e vet nuk kurse për specialiste duro-alumini/plastik PVC. Gjithashtu në Formularin e Vetëdeklarimit nuk janë plotësuar të dhënat që kërkon Autoriteti Kontraktor sipas kriterit: Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emër/mbiemër, profili i punës (titulli diplomës/certifikatës së lëshuar kualifikimin përkatës kualifikimit), numri amzës, institucionin që ka lëshuar kualifikimin përkatës. Bashkëlidhur dokumenti i paraqitur në SPE dhe informacioni në lidhje me QTA.

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron.**

VIII. Për sa i përket argumentit të OE ankues lidhur me pretendimin se OE nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 12. Pika 1, shkronja b) pasi për Kanionin me vinte të marrë me qira, së pari nuk ka paraqitur certifikatë për transport mallrash brenda vendit (për të tretët) si dhe se dyti, kontrata nuk është për objektin e procedurës objekt ankese, KSHA konstaton se në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk janë deklaruar të dhënat dhe nuk ka paraqitur certifikatë për transport mallrash brenda vendit sipas kriterit 12 në DST, konkretisht:

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarku paraqitet a dokumenti vërteton vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

Për sa më sipër, referuar parashikimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. **KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për këtë pikë, qëndron.**

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 e Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, sipas të cilës "Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës. 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës", Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, **VENDOSI:**

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të OE "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k., për procedurën "Rikonstruksion Objekti, Heqje dhe Furnizim-Vendosje Dyer dhe Dritare për FSHMT, Tiranë", me nr. REF-22803-10-04-2024.

2. Dërgimin e vendimit të arsyetuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatorit Ekonomik "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k. dhe operatorët ekonomikë të interesuar.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: "1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimarrje për pjesën tjetër.

Në kushtet kur nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 3336 prot., datë 13.11.2024, të operatorit ekonomik "Kevin Konstruktion" SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Kevin Konstruktion" SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik "Ina" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mos i marrë në shqyrtim, porsa kohë gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik

“Ina” SHPK, referuar arsytimit të bërë në këtë vendim do të ndryshojë nga “e kualifikuar” në “e skualifikuar”, duke përbushur kështu interesin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Ina” SHPK.

III.3.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “Drini-1” & “Ndërtimi” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ina” SHPK dhe operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1.Në datën 07.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur-Punë”, me Nr. REF-22803-10-04-2024, me objekt “Rikonstruktion Objekti, Heqje dhe Furnizim-Vendosje Dyer dhe Dritare për FSHMT, Tiranë”, me fond limit 36,912,500 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind), zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

III.3.2. Në datën 22.10.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.3.3.Në datën 30.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

INA SHPK	30,234,001.56	Kualifikuar
Kevin Konstruktion SHPK	30,450,030.64	Kualifikuar
BOE “Drini -1+ Ndertimi” SHPK	34,839,270.00	Kualifikuar
“Ndregjoni” SHPK	36,251,969	Kualifikuar

III.3.4. Në datën 06.11.2024, është kryer publikimi i njoftimit të fituesit paraprak në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

III.3.5. Në datën 13.11.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4787 dhe me nr. 3347/1/2024 protokoli, datë 13.11.2024, e BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ina” SHPK dhe “Kevin Konstruktion” SHPK, në procedurën objekt-ankimi.

III.3.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3347/3 prot,

datë 14.11.2024, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ina” SHPK dhe “Kevin Konstruktion” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.3.7. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor me shkresën nr.2372/30 prot., datë 21.11.2024, protokolluar me tonën me nr.3347/5prot., datë 21.11.2024, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK.

III.3.8. Në nenin 116 të Kushtetutës parashikohet se: *“1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:*

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.”

III.3.9. Neni 24, pika 1, “Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”

III.3.10. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.3.11. Në nenin 110, pikat 2, 7, 8 dhe 9 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/të klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave.

9. Sistemi i prokurimit elektronik njofton operatorët ekonomikë në mënyrë automatike për datën e fillimit dhe të përfundimit të afateve të ankimit.”

III.3.12. Në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

III.3.13. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.3.13. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

III.3.14. Në nenin 115 pika 1, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.”

III.3.15. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: “a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”*

III.3.16. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar (siç është procedura e prokurimit objekt ankimi), në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak (06.11.2024), ka qenë data 12.11.2024. Ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik e depozituar në sistemin e ankesave elektronike nga operatori ekonomik, BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK, është paraqitur në datën 13.11.2024, pra jashtë afateve të ankimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar në sistemin e ankesave elektronike jo më vonë se në datën 12.11.2024, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në nenin 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.*

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110 pika 2 e ligjit 162/2020, i ndryshuar, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit me datë 06.11.2024 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ka qenë data 12.11.2024. Ndërkohë ankesa e depozituar me datë 13.11.2024 njëherazi në KPP dhe në autoritet kontraktor përmes sistemit elektronik të ankesave konsiderohet e paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, germa “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;*”

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në sistemin e ankesave elektronike, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me këtë rast, KPP gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë por edhe me Kushtetutën si ligji më i lartë në vend referuar parashikimeve të nenit 4/2 të saj. Kushtetuta vetë parashikon hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore. Kuadri kushtetues ka parashikuar hierarkinë e normave ligjore në nenin 116 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se:

“1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. *Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.*”

Në këtë kuadër Kushtetuta vetë, duke folur për hierarkinë e akteve normative në nenin 116 të saj, parashikon akte normative që janë “nën” ligjet siç është në rastin konkret VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në këtë mënyrë, duke qenë se ligjet kanë epërsi mbi aktet normative të Këshillit të Ministrave, KPP në vendimmarrjen e tij i qëndron strikt këtij rregullimi si organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, i cili ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse duke llogaritur afatet e ankimit të operatorëve ekonomikë sipas parashikimeve të nenit 110 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.17. Lidhur me vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik, BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj., përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhshmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor, por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetëiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.SH.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, ku një prej të cilave është dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave në asnjë rast

nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit, duke nxjerrë në këtë mënyrë një akt në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe referuar ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë ligjore. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i KSHA për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik BOE “Drini-1” shpk & “Ndërtimi” SHPK (përmes aktit nr.2372/30 prot., datë 21.11.2024 “Vendim”), është në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur-Punë”*, me Nr. REF-22803-10-04-2024, me objekt *“Rikonstruktion Objekti, Heqje dhe Furnizim-Vendosje Dyer dhe Dritare për FSHMT, Tiranë”*, me fond limit 36,912,500 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind), zhvilluar në datën 22.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ina” SHPK, duke e skualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA nr.2372/29 prot., datë 21.11.2024
3. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini-1” SHPK & “Ndërtimi” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KSHA nr. 2372/30 prot., datë 21.11.2024 për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini-1” SHPK & “Ndërtimi” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK
7. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini-1” SHPK & “Ndertimi” SHPK
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri